



DOKUMENT PËR POLITIKA PUBLIKE

# PJESËMARRJA E PUBLIKUT NË PLANIFIKIMIN URBANISTIK



DOKUMENT PËR POLITIKA PUBLIKE

## **PJESËMARRJA E PUBLIKUT NË PLANIFIKIMIN URBANISTIK**

Shkup, 2022

**Botues:** Shoqata maqedonase e juristëve të rinj - SHMJR  
rr."Donbas" nr. 14/1-6, 1000 Shkup  
[www.myla.org.mk](http://www.myla.org.mk) /[contact@myla.org.mk](mailto:contact@myla.org.mk)  
tel.02/3220 870

**Autor:** Jasna Orovčanec Arangjeloviq

**Lektura:** Vesna Kostovska

Dizajni: ADD - Verta LTD, Shkup

<b>Lista e shkurtesave</b>	<b>3</b>
<b>Rreth dokumentit</b>	<b>4</b>
<b>Hyrje</b>	<b>5</b>
<b>1. Procesi i planifikimit urbanistik dhe pjesëmarrja e publikut</b>	<b>5</b>
<b>2. Legjislacioni për pjesëmarrjen e publikut në planifikimin urbanistik</b>	<b>6</b>
<b>2.1 Ligji për planifikimin urbanistik</b>	<b>6</b>
<b>2.2 Konventa e Aarhusit</b>	<b>7</b>
<b>2.3 Ligji për mjedisin jetësor</b>	<b>8</b>
<b>3. Të dhënat nga komunat lidhur me pjesëmarrjen e publikut në planifikimin urbanistik</b>	<b>8</b>
<b>3.1 Kryerja e intervistës me sektorin e urbanistikës</b>	<b>8</b>
<b>3.2 Trupi pjesëmarrës dhe të dhënat e marra përmes kërkesave të parashtruara për qasje të lirë në informacion me karakter publik</b>	<b>10</b>
<b>4. Përfundime dhe rekomandime</b>	<b>11</b>

### Lista e shkurtesave

RMV – Republika e Maqedonisë së Veriut

LPU – Ligji për planifikim urbanistik

LMJ – Ligji për mjedisin jetësor

## Rreth dokumentit

Dokumenti është përpiluar në kuadër të projektit «Organizatave civile në veprim për ndryshimet klimatike», i mbështetur nga Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar si donatore dhe i implementuar nga Qendra për hulumtim dhe informim për mjedisin jetësor "Eko-vest" nga Shkupi, Shoqata maqedonase e juristëve të rinj (SHMJR) dhe Organizatës lidhja e vlerave natyrore dhe njerëzve-CNVP.

Ky dokument synon të japë një pasqyrë të rëndësisë së pjesëmarrjes së publikut në planifikimin urban si një proces kompleks që lidhet me nevojat e njerëzve dhe zhvillimin e hapësirës në të cilën ata jetojnë. Dokumenti do të japë një përshkrim se çfarë është planifikimi urban, pse është e rëndësishme pjesëmarrja e publikut, një pasqyrë e ligjit bazë që rregullon këtë fushë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, si dhe se si zbatohen zgjidhjet e caktuara ligjore në praktikë nga aspekti i pjesëmarrjes publike.

Duke pasur parasysh faktin se planifikimi urban ndikon në mjedis jetësor, do të mbulohen disa rregullore që kanë të bëjnë me pjesëmarrjen e publikut në lëmin e mjedisit jetësor. Nga dokumenti do të dalin disa përfundime dhe rekomandime, të cilat në të ardhmen mund të kenë ndikim në krijimin ose përmirësimin e politikave të caktuara në këtë lëmi.

Dokumenti është përgatitur duke përdorur veglën e hulumtimit në zyrë, duke kryer intervista dhe duke përdorur të dhënat e marra përmes kërkesave të parashtruara për qasje të lirë në informacione me karakter publik.

## Hyrje

Planifikimi urbanistik është proces kompleks i rregullimit të mjedisit jetësor dhe organizimit të hapësirës. Pasqyron ngritjen dhe zhvillimin e qyteteve dhe përshtatjen e hapësirës me nevojat e komunitetit. Përveç planifikimit fizik, rol të rëndësishëm në procesin e planifikimit urbanistik luajnë edhe faktorët ekonomikë, socialë dhe ndikimi i mjedisit jetësor. Faktorët ekonomikë të planifikimit urbanistik i referohen ndikimit që ka në ekonominë lokale dhe bizneset lokale, kurse kjo lidhet drejtpërdrejt me nevojat dhe ndikimin e drejtpërdrejtë të komunitetit lokal dhe qytetarëve që jetojnë në një zonë të caktuar. Me rëndësi të veçantë është ndikimi që ka planifikimi dhe zhvillimi urbanistik në mjedis jetësor, me çka është i nevojshëm vlerësimi i një ndikimi të tillë. Vlerësimi joadekuat ose i pamjaftueshëm i ndikimit të planifikimit urbanistik mund të rezultojë në një numër të madh ankesash nga qytetarët e prekur drejtpërdrejt të një komuniteti të caktuar lokal. Për këto arsye, planifikimi urbanistik duhet të mundësojë shfrytëzim racional të hapësirës që do t'i merr parasysh nevojat e qytetarëve.

## 1. Procesi i planifikimit urbanistik dhe pjesëmarrja e publiku

Procesi i planifikimit urbanistik duhet të jetë në përputhje me normat ekzistuese, e cila mbulon më shumë sfera. Planifikimi bazohet në vendimmarrje nga autoritetet qendrore dhe lokale, të cilat duhet të lejojnë pjesëmarrjen e publikut.

Pjesëmarrja e publikut nënkupton të drejtën e qytetarëve për t'u përfshirë dhe për të pasur ndikim në vlerësimin e nevojave dhe në procesin e vendimmarrjes. E drejta e qytetarëve buron nga fakti se ata janë ato që do të përballen me pasojat e planifikimit urbanistik në jetën e përditshme dhe mënyrën e tyre të jetesës. Pjesëmarrja e qytetarëve është kusht për të ashtuquajturën demokraci pjesëmarrëse lokale, e cila është një proces kolektiv i vendimmarrjes në të cilin autoritetet dhe qytetarët punojnë së bashku në krijimin e politikave<sup>1</sup>.

Proceset e vendimmarrjes në të gjitha fazat e planifikimit urban njohin dy qasje: Top-down (nga lart poshtë) – Planifikimi "top-down" nënkupton organizimin vertikal të të gjithë procesit ku marrja e të gjitha vendimeve në lidhje me planin përcaktohet dhe varet nga qendrat e pushtetit (mbreti, politikanët, planifikuesit, korporatat, etj.). Një qasje e tillë në planifikim sot konsiderohet retrograde, sepse ata kanë të drejtën ekskluzive për të krijuar rend shoqëror dhe hapësinor në shoqëri, duke krijuar mundësinë që vendimet të mos reflektojnë nevojat e të gjithë banorëve të qytetit, pra të krijohen kushte për diskriminim (klasor, racor, etnik dhe të ngjashme).

Bottom-up (nga poshtë lart) – Planifikimi "bottom-up", mbi të gjitha i referohet ndryshimit të marrëdhënieve të pushtetit me rishpërndarjen e tij horizontale në sistemin vendimmarrës. Një qasje e tillë në planifikimin urbanistik arrihet përmes përfshirjes së numrit më të madh të mundshëm të palëve të interesuara në të gjitha fazat e proceseve të planifikimit. Qëllimi i planifikimit "bottom-up" është procesi i përgjithshëm i ideve, vendimeve dhe planeve që kanë të bëjnë me organizimin hapësinor (social) të qytetit për të përparuar nga shtresat shoqërore që nuk kanë fuqi menaxhuese dhe më së shumti ndikohet nga planifikimi hapësinor, gjegjësisht, mbi të gjitha përfshin qytetarët si përdorues të hapësirës së qytetit dhe synon të

<sup>1</sup> <https://www.hellolamppost.co.uk/blog/the-importance-of-public-participation-in-urban-planning>

inkorporojë iniciativat e tyre, sepse në këtë mënyrë mbrohet interesi publik<sup>2</sup>.

Qëllimet kryesore, të cilat mund të arrihen me një nivel më të lartë të pjesëmarrjes së publikut, janë: 1. sigurimi i mundësisë për të dëgjuar pikëpamjet e publikut dhe për t'u përfshirë në procesin e planifikimit dhe vendimmarrjes, me qëllim përmirësimin e planeve dhe ndikimin e tyre real në ngritjen e cilësisë së jetës së përditshme; 2. promovimi i ndjenjës së komunitetit duke ndarë qëllimet e përbashkëta të të gjitha palëve të përfshira dhe 3. rritjen e ndërgjegjësimit për problemet dhe nevojën për pjesëmarrje të drejtpërdrejtë dhe aktive në krijimin e mënyrave të mundshme për zgjidhjen e tyre.

Koncepti i pjesëmarrjes së publikut në planifikimin urbanistik është i përhapur dhe i pranuar, zbatimi nuk është gjithmonë ashtu siç është konceptuar, pra i rregulluar sepse planifikimi urbanistik është një proces kompleks. Kjo varet, para së gjithash, nga qëndrueshmëria e autoriteteve në përfshirjen e publikut në vendimmarrje dhe nga mirëkuptimi dhe interesi real i qytetarëve për të marrë pjesë në planifikimin urban.

## 2. Legjislacioni për pjesëmarrjen e publikut në planifikimin urbanistik

### 2.1 Ligji për planifikimin urbanistik

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut (RSM), ligji bazë që rregullon planifikimin urbanistik është Ligji për planifikim urbanistik<sup>3</sup> (LPU), miratuar në vitin 2020, i cili përfshin dispozita për pjesëmarrjen e publikut në procesin e planifikimit, si dhe dispozita që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit jetësor.

Me LPU rregullohet rregullimi sistemor dhe hierarkik i planifikimit urbanistik në sistemin e planifikimit hapësinor dhe urbanistik, qëllimet dhe parimet e planifikimit urbanistik dhe rregullimi i hapësirës, llojet dhe përmbajtja e planeve urbanistike, kushtet për kryerjen e punëve nga sfera e planifikimit urbanistik, procedurat për përpilimin, miratimin dhe zbatimin e planeve urbanistike, mbikëqyrja mbi zbatimin e dispozitave të këtij ligji, si dhe punët tjera nga sfera e planifikimit urbanistik<sup>4</sup>.

Sipas LPU-it, planifikimi urban funksionon për arritjen e qëllimeve, realizimi i të cilave është obligim i të gjithë pjesëmarrësve në procesin e krijimit, miratimit dhe zbatimit të planeve urbanistike, ndër të cilat janë: 1. zhvillimi i balancuar hapësinor; 2. rregullimi dhe shfrytëzimi racional i hapësirës; 3. krijimi dhe përmirësimi i kushteve për jetë dhe punë humane të qytetarëve; 4. ruajtjen e cilësisë dhe përmirësimin e mjedisit jetësor dhe natyrës; 5. menaxhimi me ndryshimet klimatike.

Parimet sipas të cilave zhvillohet procesi i planifikimit urbanistik janë pjesëmarrja e **publikut në procedurën** e krijimit, miratimit dhe zbatimit të planeve, si dhe gjithëpërfshirja dhe pjesëmarrja në procedurën e krijimit, miratimit dhe zbatimit të planeve<sup>5</sup>.

2 [http://www.arh.ukim.edu.mk/images/Predmeti/UrbanistickoPlaniranjeII/UP2\\_2020-21/Predavanje\\_24.pdf](http://www.arh.ukim.edu.mk/images/Predmeti/UrbanistickoPlaniranjeII/UP2_2020-21/Predavanje_24.pdf)

3 Ligji për planifikim urbanistik "Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 32 datë 10.2.2020

4 LPU, neni 1

5 Ligji për planifikim urbanistik, neni 9.

Varësisht nga përfshirja e planifikimit urbanistik, si dhe nga ajo nëse lënda e planifikimit është me rëndësi shtetërore ose lokale, miratohen planet urbanistike vijuese: 1. Plan i përgjithshëm urbanistik; 2. Plan i detajuar urbanistik; 3. Plan urbanistik për fshat; 4. Plan urbanistik për vend jashtë vendbanimit dhe 5. Plan urbanistik për zonat dhe objektet me rëndësi shtetërore<sup>6</sup>.

Për hartimin e planeve urbanistike organi i administratës shtetërore që është përgjegjës për kryerjen e punëve në fushën e planifikimit hapësinor nxjerr kushte për planifikimin hapësinor. Kushtet për planifikim hapësinor përmbajnë udhëzime për nevojën e zbatimit të Vlerësimit strategjik të ndikimit në mjedisin jetësor në përputhje me Ligjin për mjedis jetësor<sup>7</sup>.

Procedura e krijimit dhe miratimit të planeve urbanistike kryhet në formë digjitale, pra elektronike, nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizim, i cili shërben për të lidhur të gjithë pjesëmarrësit në procesin e krijimit dhe miratimit të planeve urbanistike si përdorues të sistemit të vetëm qendror informacioni, që përbëhet nga pajisje teknike, baza të të dhënave dhe programeve softuerike. Procedura e krijimit dhe miratimit të planeve urbanistike kryhet edhe në mënyrë analoge, pra në formë letre, edhe atë kur plani paraqitet për ekspertizë dhe para miratuesit, në anketim publik dhe prezantim publik, por edhe si plan i miratuar në përputhje me ligjin. Ligji përcakton se cilët janë përdoruesit e autorizuar. Sistemi informativ e-urbanizëm duhet të ketë një seksion të hapur, gjegjësisht ueb faqe që do të mundësojë qasje të hapur dhe të lirë për publikun në procedurën e miratimit të planeve urbanistike që përmban fazat kryesore të procedurës: programin e planifikimit, draft planin dhe propozim planin. Pjesa e hapur e sistemit duhet të mundësojë qasje në të gjitha planet urbanistike të miratuara që janë në fuqi. Sistemi informativ e-urbanizëm duhet të ketë gjithashtu një arkiv për planet e miratuara më parë që nuk janë më në fuqi.

Planet urbanistike përpunohen në bazë të programit të planit, i cili pas miratimit detyrimisht shpallet në ueb-faqen e miratuesit për inspektim publik, kurse programi i planifikimit nga paragrafi (8) i këtij neni postohet edhe në ueb faqen e komunave<sup>8</sup>.

Për të siguruar përfshirje, pjesëmarrje dhe kontribut më të madh të qytetarëve, si dhe publikut në procesin e planifikimit urbanistik, në punën e të cilit marrin pjesë përfaqësues të sektorit civil dhe joqeveritar nga komuniteti lokal, njësitë e vetëqeverisjes lokale formojnë trup pjesëmarrës me iniciativë të kryetarit ose pjesëmarrësve<sup>9</sup>. Trupi pjesëmarrës përfaqëson të gjitha interesat dhe grupet e interesit në bashkësinë lokale dhe përcjell qëndrimet, mendimet dhe nevojat e qytetarëve dhe personave juridikë, monitoron gjendjen e planifikimit duke dhënë iniciativa, udhëzime dhe sugjerime për përgatitjen e aktvendimeve të planifikimit dhe në procedurë për hartimin dhe miratimin e planeve, shqyrton programet e planit dhe aktvendimet e planeve urbanistike në versionin e tyre të punës. Trupi Pjesëmarrës ka të drejtë të diskutojë për të gjitha çështjet brenda kompetencave të njësisë së vetëqeverisjes lokale dhe mund të ndikojë në vendimet e planit dhe politikat e zhvillimit

6 LPU, neni 10.

7 LPU, neni 42

8 LPU, neni 44

9 Trupi pjesëmarrës i përbërë nga anëtarët e Komisionit për Urbanizëm të komunës, komunës në qytetin e Shkupit dhe qyteti i Shkupit, i cili përcakton kryetarin e komunës dhe personat profesionistë të punësuar në personin juridik që përgatit plan urbanistik që është lëndë diskutimi, sidomos nga personat të cilët janë përfaqësues të bashkësive urbane dhe lokale, përfaqësues të organizatave jo-qeveritare nga segmente të ndryshme të jetës urbane, shoqatave qytetare dhe aktivistëve të shoqërisë civile në komunë që përfaqësojnë grupe të ndryshme të qytetarëve, dhe qytetarë të cilët janë ekspertë në fushën e planifikimit urbanistik dhe fusha të tjera të ekspertëve që janë thelbësore për planifikimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të qytetit. Trupi pjesëmarrës formohet nga persona të paraqitur vullnetarisht nëpërmjet shpalljes publike të publikuar në ueb faqen e njësisë së vetëqeverisjes lokale dhe në formë me shkrim me vendosjen e shpalljes në vend publik në kohëzgjatje prej 30 ditësh.

hapësinor, nëpërmjet prezantimit të mendimeve të veta këshillit të komunës. Trupi ka rol konsultativ në procedurën për hartimin dhe miratimin e planeve urbanistike, në veçanti duke marrë parasysh programin e planit në një fazë përpara se të propozohet nga kryetari i komunës për miratim, si dhe planin urbanistik në fazën aktvendimit të planit urbanistik para se të jepet në rishikim profesionist. Puna e trupit pjesëmarrës është publike<sup>10</sup>.

Në procedurën për përgatitjen e planeve urbanistike, zbatohet në mënyrë të detyrueshme debate profesionale, me ç'rast aktvendimet e planit do të vihen në dispozicion për inspektim dhe kontroll të publikut profesional, si dhe prezantimit publik, me të cilin vendimet e propozuara të planit vihen në këqyrje të publikut të gjerë. Prezantimi publik me anketën publike bëhet në mënyrë të detyrueshme, ku propozimi ose drafti i planit urbanistik (në një gjuhë të qartë dhe të kuptueshme për publikun e gjerë) vendoset për inspektim publik dhe inspektim nga personat fizikë dhe juridikë të interesuar nga zona e planifikimit, zonat ngjitur me mbulimin e zonës së planifikimit, si dhe publikun e gjerë<sup>11</sup>. (neni 49)

Ligji parashikon afate në lidhje me publikimin e thirrjes për prezantim dhe anketën publike, mënyrën e realizimit të anketës publike (në formë elektronike dhe në letër), afatet në të cilat kryhen të gjitha veprimet, mënyrën e dhënies së sugjerimeve dhe komenteve nga ana e pjesëmarrëseve, mënyrën dhe përgjegjësitë për të bërë një raport lidhur me vërejtjet në plan, si dhe pasojat e vërejtjeve në plan. Zgjidhja ligjore është domethënëse që nëse propozimi i planit, si rezultat i komenteve të pranuar nga anketa publike, ka pësuar ndryshime të rëndësishme (ndryshim i kufirit të shtrirjes urbane, ndryshim i vijës rregulluese dhe ndryshim i përdorimit të tokës, etj.), plani kthehet për një rishikim, prezantim dhe një anketë publike bëhen përsëri sipas të njëjtës procedure<sup>12</sup>. (neni 50)

Në këtë mënyrë, ligji i ri rregullon pjesëmarrjen e publikut në planifikimin urbanistik, duke mundësuar hapjen dhe gjithëpërfshirjen e publikut të gjerë përmes një procedure të përcaktuar saktësisht.

## 2.2 Konventa e Aarhusit

Bazat e konceptit të pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrjen e çështjeve të mjedisit jetësor që burojnë nga Konventa e Aarhusit, e cila bazohet në 3 shtylla, njëra prej të cilave i referohet pjesëmarrjes së publikut në çështjet e mjedisit jetësor. Pjesëmarrja e publikut përfshin pjesëmarrjen në vendimmarrje, gjegjësisht miratimin e funksionimit të aktiviteteve të renditura në Aneksin 1 të Konventës<sup>13</sup>; pjesëmarrja e publikut në përgatitjen e planeve dhe programeve që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor dhe pjesëmarrja e publikut në rregullat e përgjithshme ligjore dhe dispozitat ekzekutive që mund të ndikojnë dhe lidhen me mjedisin jetësor<sup>14</sup>.

10 LPU, neni 46

11 LPU, neni 49

12 LPU, neni 50.

13 Konventa për qasjen në informacion, pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje dhe qasjen në të drejtat për çështjet mjedisore (Konventa e Aarhusit <https://unece.org/DAM/env/pp/documents/cep43e.pdf>)

14 Ibid, neni 8



## Ligji për mjedisin jetësor

Pjesëmarrja e publikut është e paraparë edhe me Ligjin për mjedisin jetësor<sup>15</sup> (LMJ), fillimisht me parimin e pjesëmarrjes së publikut dhe qasjen në informacion, sipas të cilit "organet e qeverisjes shtetërore dhe organet e vetëqeverisjes vendore janë të detyruara të sigurojnë të gjitha masat e nevojshme dhe të përshkruajnë procedurat që sigurojnë ushtrimin e së drejtës për qasje në informacion dhe pjesëmarrjen e publik në marrjen e vendimeve në lidhje me gjendjen e mjedisit, si dhe për të dhënë deklaratë për publikun në procedurën e marrjes së atyre vendimeve".<sup>16</sup>

E rëndësishme nga pikëpamja e përgatitjes së të gjitha planeve, përfshirë planet urbanistike, është parimi i integritetit sipas të cilit parimet dhe objektivat e politikës për mbrojtjen dhe promovimin e mjedisit duhet të integrohen në të gjitha zhvillimet, strategjike, planifikimet dhe dokumentet programore të miratuara nga autoritetet e pushtetit shtetëror dhe organet e vetëqeverisjes lokale.<sup>17</sup>

Për më tepër, ligji rregullon pjesëmarrjen e publikut dhe detyrën e autoriteteve kompetente për të përcaktuar publikun që do ose mund të preket dhe për të vendosur vendime ose dokumente planifikuese në dispozicion të publikut në fazën më të hershme të fillimit të procedurës për miratimin e tyre. Ky ligj përmban dispozita të tjera që rregullojnë mënyrat e raportimit dhe mundësitë të pjesëmarrjes së publikut.

## Të dhënat nga komunat lidhur me pjesëmarrjen e publikut në planifikimin urbanistik

### 3.1 Kryerja e intervistës me sektorin e urbanistikës

Me qëllim për të patur ide për zbatimin e dispozitave të LPU-it, është realizuar intervistë me një person në pozitë udhëheqëse në njërin nga komunat e Qytetit të Shkupit. Gjatë intervistës së realizuar me një person në pozitë udhëheqëse në sektorin e urbanistikës në komunën e Qytetit të Shkupit, janë bërë disa pyetje, përkatësisht:

- A është dhe sa është i përfshirë publiku i gjerë në hartimin e planeve urbanistike?
- A kryhet procedura për prezantim publik dhe anketim publik sipas LPU-it?
- Cilat janë vërejtjet më të zakonshme të publikut të gjerë gjatë realizimit të prezantimit publik dhe anketimit publik?
- A shpreh publiku i gjerë interesim të mjaftueshëm për procesin e planifikimit urbanistik dhe nëse jo, cilat janë arsyet?
- A funksionon pa probleme sistemi informativ e-urbanizmi?

Sipas përgjigjeve të dhëna, publiku i gjerë përfshihet në procedurën e hartimit të planeve urbanistike dhe prezantimi publik, si dhe anketa publike bëhen në përputhje me LPU-in. Në kuadër të anketës publike, çdo fletë anketimi konsiderohet veçmas dhe pranohet, nuk pranohet ose pranohet pjesërisht, për të cilën jepet një shpjegim i detajuar për arsyet për të cilat pranohet ose nuk pranohet një vërejtje e caktuar në fletën e anketimit. Nëse në kuadër të anketimit publik ka vërejtje për planin (ndryshim i kufirit të objektit urbanistik, ndryshim i vijës rregulluese dhe ndryshim i

<sup>15</sup> Ligji për mjedisin jetësor, «Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë» nr. 53/05, 81/05, 24/07, 159/08, 83/09, 48/10, 124/10, 51/11, 123/12, 93/13, 187/13, 42/14, 44/15, 129/15, 192/15, 39/16 и 99/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 89/22, neni 17.

<sup>16</sup> LMJ, neni 17

<sup>17</sup> LMJ, neni 7

përdorimit të tokës), procedura kryhet sërish. Në shumicën e rasteve, procedura për krijimin e planit urbanistik, konkretisht të planit të detajuar urbanistik, përsëritet tre deri në katër herë para se të miratohet, duke përfshirë një prezantim publik dhe një anketë publike. Vërejtjet më të shpeshta të publikut që preken nga shtrirja e planit urbanistik janë përmasat e ndërtimit të tyre (gjerësia dhe lartësia e objektit), si dhe shndërrimi i objektit nga kategoria A1 – banesa individuale banimi në shtëpi të kategorisë A2 – banimi banesor në ndërtesë. Vërejtje jepen për projektimin e rrugëve, për shembull, kur zënë një pjesë të parcelave të qytetarëve që janë pronë private (pjesë e një oborri) etj.

Çështjet e ndikimit në mjedis jetësor, si p.sh. sa hapësirë të gjelbër ka brenda një PDU, nuk janë çështje për të cilat publiku i prekur nga objekti i planit ka kundërshtime, si dhe nëse ka, ato përfaqësojnë një përqindje veçanërisht të vogël të fletëve të anketimit. Sa i përket çështjeve mjedisit jetësor, komente bëhen nga publiku që nuk preket drejtpërdrejt nga objekti i planit urbanistik. Publiku shpreh interes të mjaftueshëm për procesin e planifikimit urbanistik dhe në një prezantim publik mund të jenë të pranishëm 400 e më shumë qytetarë. Sistemi informativ e-urbanizëm funksionon pa probleme dhe të gjitha dokumentet e ofruara janë në dispozicion, por është e diskutueshme se sa të kuptueshme dhe të qarta janë dokumentet për publikun e gjerë dhe sa i përdorin ato.

### **3.2 Trupi pjesëmarrës dhe të dhënat e marra përmes kërkesave të parashtruara për qasje të lirë në informacion me karakter publik**

Një nga përfitimet më domethënëse të LPU-it është **formimi i trupit pjesëmarrës** i detyrueshëm nga ana e komunave, komunave në Qytetin e Shkupit dhe Qyteti i Shkupit. Trupi pjesëmarrës përfaqëson të gjitha interesat dhe grupet e ndryshme të interesit dhe në të cilin pjesëmarrës do të jenë anëtarë të komisionit të urbanistikës së njësisive të vetëqeverisjes lokale, të cilët përcaktohen nga kryetari i komunës dhe ekspertët e punësuar nga personi juridik që përgatit planin urbanistik që është objekt diskutimi, përfaqësues të komuniteteve urbane dhe lokale, përfaqësues të organizatave joqeveritare nga segmentet e ndryshme të jetës urbane, shoqata të qytetarëve dhe aktivistë civilë nga zona e komunës që përfaqësojnë grupe të ndryshme të qytetarëve, si dhe qytetarë të cilët janë ekspertë në fushën e urbanistikës dhe fushave të tjera thelbësore profesionale për planifikimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të qytetit.

Me qëllim të mbledhjes së informatave në lidhje me zbatimin e LPU-së, Shoqata maqedonase e juristëve të rinj ka dorëzuar kërkesa për qasje të lirë në informata me karakter publik në 81 komuna (të gjitha) dhe ka kërkuar informacion nëse komunat kanë formuar një trup pjesëmarrës për planifikim urbanistik në përputhje me nenin 46 të LPU-së dhe nëse është formuar, kush e përbën atë trup pjesëmarrës. Informacioni nuk është dhënë nga vetëm një komunë. Nga informacionet e ofruara për 80 komuna, gjithsej 34 komuna janë përgjigjur se nuk kanë themeluar një trup pjesëmarrës brenda komunës. Pesë komuna janë përgjigjur se trupi pjesëmarrës është në fazën e formimit. Komunat e mbetura, gjithsej 41, kanë dorëzuar informacione se është formuar një trup pjesëmarrës, disa nga komunat kanë dorëzuar informacione se cilët janë anëtarë të organit pjesëmarrës dhe disa nuk kanë dorëzuar.

Sipas informacioneve të marra nga komunat që kanë formuar një trup pjesëmarrës, disa kanë deklaruar se është formuar dhe nuk kanë dhënë informacion se kush e ka përbërë atë. Sipas të dhënave nga komunat që kanë dorëzuar informacione se kush e përbën trupin pjesëmarrës, përgjigjet se kush e përbën trupin pjesëmarrës ndryshojnë

në komuna të ndryshme. Sipas njërës përgjigje, trupi pjesëmarrës përbëhet nga punonjës të komunës dhe anëtarë të jashtëm të regjistruar me thirrje publike; përgjigja e një komune tjetër është se organi formohet nga kryetarët e komuniteteve lokale, të punësuar në sektorin e urbanistikës; më tej, ka përgjigje se është themeluar një trup pjesëmarrës, i përbërë nga anëtarë të komisionit të urbanistikës dhe ekspertë të urbanistikës të autorizuar nga komuna; organ pjesëmarrës prej 5 anëtarësh, i përbërë nga anëtarë të këshillit, anëtarë me sugjerim të bashkësisë lokale, anëtarë nga shoqatat e qytetarëve dhe administrata komunale.

#### 4. Përfundime dhe rekomandime

Mund të konkludohet se pjesëmarrja e publikut në planifikimin urbanistik është një koncept që njihet si i rëndësishëm. Sipas dispozitave në Ligjin për planifikim urbanistik, të cilat i referohen pjesëmarrjes së publikut, mund të konstatohet se konceptit të pjesëmarrjes së publikut i kushtohet rëndësi dhe jepen zgjidhje ligjore për zbatimin e tij. Ligjet janë një çështje e gjallë dhe ato gjithmonë mund t'i nënshtrohen ndryshimeve dhe/ose plotësimeve të mëtejshme, në varësi të zhvillimit aktual dhe nevojave të shoqërisë.

Nga intervista e realizuar me një person udhëheqës dhe nga të dhënat e mbledhura nga komunat, mund të konstatohet se mundësia e pjesëmarrjes së publikut është e sigurt për sa i përket prezantimeve dhe anketave publike, por publiku shpreh interesim më së shumti për çështje që prekin interesin privat të çdo qytetari individual, dhe mungon interesi kolektiv në fushën e mbrojtjes dhe ndikimit në mjedisin jetësor. Nga të dhënat e mbledhura nga komunat, mund të konstatohet se ka mospërputhje në zbatimin e ligjit për sa i përket trupit pjesëmarrës, i cili është një nga zgjidhjet kryesore ligjore për përfshirjen e të gjitha palëve të interesuara në procesin e planifikimit urban.

Rekomandimet që dalin nga aspektet e pjesëmarrjes së publikut në planifikimin urbanistik mund t'i referohen rritjes së ndërgjegjësimit të publikut për rëndësinë e të gjitha aspekteve të planifikimit urbanistik, duke përfshirë ndikimin në mjedisin jetësor, pa neglizhuar interesin privat ose interesat e biznesit lokal që ato nuk duhet të jenë të vetmet ose fokusi kryesor.

Është e nevojshme të monitorohet zbatimi i ligjeve, në këtë rast të veçantë Ligji për planifikim urbanistikë, në mënyrë që të përfshihen plotësisht të gjithë palët e interesit në procesin e planifikimit urbanistik, si dhe të përmirësohet funksionimi i sistemit elektronik e-urbanizëm.

